

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2019

Tiranë, më 23 Janar 2020:


Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Dhjetor 2019, janë 897.696.

Krahasuar me Dhjetor 2018, ky tregues rezulton me rritje 7,7 %. Në Dhjetor 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 288.708, krahasuar me Dhjetor 2018 ky numër është rritur me 2,9 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë gjatë vitit 2019 është 6.406.038, duke u rritur me 8,1 %, në krahasim me vitin 2018. Në Dhjetor 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Gjermania, krahasuar me Dhjetor 2018.

Gjatë vitit 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 18,2 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 13,9 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Dhjetor 2019, janë 784.404 duke shënuar një rritje me 19,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2019, janë 485.230, krahasuar me Dhjetor 2018, ky numër është rritur 8,8 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2019, janë 299.174, krahasuar me Dhjetor 2018 ky numër është rritur 42,9 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë gjatë vitit 2019, është 5.921.750 duke u rritur 9,4 %, krahasuar me vitin 2018.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Jan.- Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	833.200	897.696	7,7	11.246.520	12.103.767	7,6
Shqiptarë	552.501	608.988	10,2	5.319.717	5.697.729	7,1
Të Huaj	280.699	288.708	2,9	5.926.803	6.406.038	8,1
Dalje Gjithsej	655.415	784.404	19,7	11.432.521	12.181.435	6,6
Shqiptarë	446.032	485.230	8,8	5.415.071	5.921.750	9,4
Të Huaj	209.383	299.174	42,9	6.017.450	6.259.685	4,0

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Jan.- Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	74.616	75.211	0,8	2.088.503	2.246.540	7,6
Maqedonia e Veriut	40.676	40.655	-0,1	680.780	753.533	10,7
Greqi	54.203	56.969	5,1	552.638	596.884	8,0
Itali	28.384	31.789	12,0	436.103	467.745	7,3
Angli	7.772	8.635	11,1	126.296	133.175	5,4
Mali i zi	26.773	27.836	4,0	357.071	366.817	2,7
Poloni	455	636	39,8	153.718	132.403	-13,9
SHBA	4.078	4.414	8,2	116.978	119.179	1,9
Spanjë	631	583	-7,6	24.675	28.750	16,5
Gjermani	4.895	4.128	-15,7	142.291	165.703	16,5
Zvicër	2.958	2.750	-7,0	54.869	64.870	18,2
Të tjera	35.258	35.102	-0,4	1.192.881	1.330.439	11,5
Gjithsej	280.699	288.708	2,9	5.926.803	6.406.038	8,1

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periodha	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Jan.- Dhj. 2018	Jan.-Dhj. 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	280.699	288.708	2,9	5.926.803	6.406.038	8,1
I. Personale	274.079	279.517	2,0	5.839.626	6.304.845	8,0
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	253.301	262.426	3,6	5.639.818	6.094.889	8,1
2.Trajtim shëndetësor	34	57	67,6	276	658	138,4
3.Qëllime fetare	54	38	-29,6	778	794	2,1
4.Udhëtarë transit	20.690	16.996	-17,9	198.754	208.504	4,9
II. Biznes dhe profesionale	6.620	9.191	38,8	87.177	101.193	16,1

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periodha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Dhjetor 2018	121.666	55.457	656.077	105.352	25.845	524.218
Dhjetor 2019	144.408	57.809	695.479	142.337	25.728	616.339
Ndryshimi vjetor (%)	18,7	4,2	6,0	35,1	-0,5	17,6
Janar- Dhjetor 2018	1.474.562	799.136	8.972.822	1.485.049	794.755	9.152.717
Janar- Dhjetor 2019	1.659.594	842.904	9.601.269	1.693.936	838.515	9.648.984
Ndryshimi vjetor (%)	12,5	5,5	7,0	14,1	5,5	5,4

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.